



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**KRYETARI**

**URDHËR**

Nr. 15247, datë 27.6.2023

**PËR**

**PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE QË LINDIN NGA TITULLI EKZEKUTIV,  
VENDIMI NR. 425, DATË 28.02.2023, I GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË  
SHKALLËS SË PARË TIRANË, NË FAVOR TË KREDITORIT "SHOQËRIA  
HUMANITARE E INVALIDËVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK TË  
SHQIPËRISË"**

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 510, nenit 511 dhe nenit 515, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", të ndryshuar, udhëzimit nr. 385/7, datë 28.06.2017, të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar, udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", vendimit nr. 425 datë 28.02.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresës nr. 451 prot., datë 08.05.2023 nga Zyra Përmbarimore Private "TDR Group" sh.p.k, si dhe Memos nr. 19247 prot., datë 22.05.2023, të Drejtorisë së Ankimimeve,

**URDHËROJ:**

1. Përmbushjen e detyrimit në favor të kreditorit "Shoqëria Humanitare e Invalidëve Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Shqipërisë", lindur nga titulli ekzekutiv, vendim nr. 425, datë 28.02.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku është vendosur:

- Pranimi i kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Shoqata Humanitare e Invalidëve Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Shqipërisë.
- Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të ndërtojë rrethimin e kufijve të rinj të pronës nr. 99 "Repart Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë dhe çdo element që lidhet me rrethimin, duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme (të rehabilituar), sipas pikës 3 të VKM nr. 478, datë 17.06.2020 "Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë, të një sipërfaqe trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda

territorit të pronës nr. 99, me emërtim “Ish-Reperti Ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes së pronës (rrjet rrugor, kanalizime uji të pijshëm dhe ujëra të shkarkimit, lidhje me rrjetin e energjisë elektrike, etj) sipas parametrave e kushteve teknike që mundëson shfrytëzimin efektiv të pronës nga paditësi, sipas pikës 3 të VKM nr. 478, datë 17.06.2020 “Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje truall funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr. 99, me emërtim “Ish-Reperti Ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të krijojë të gjitha kushtet e përshtatshme për aksesueshmërinë, duke ndërtuar rrugën lidhëse me rrugën kryesore automobilistike dhe të eliminojë të gjitha pengesat infrastrukturore dhe mjedisore në pronën me emërtimin “Reperti Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, që përdorin karrige me rrota.
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë, t'i jape paditësit në përdorim, pa kundërshtim, me huapërdorje, pronën nr. 99 Reparti Ushtarak nr. 5011/45, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, në mënyrë të përshtatshme për të përmbushur qëllimin e zhvillimit të veprimtarisë së paditësit.
- Shpenzimet gjyqësore dhe ato për vënien në ekzekutim në ngarkim të palës së paditur.
- Bazuar në nenin 317 të K.Pr.Civile, vendimi jepet me ekzekutim të përkohshëm, përbën titull dhe duhet të ekzekutohet nga përbarimi gjyqësor.
- Kundër këtij vendimi, për pjesën që shprehet për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Për pjesën tjetër lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Vendimi i arsyetuar t'u komunikohet palëve.
- U shpall në Tiranë, në datë 28.02.2023.

2. Detyrimi total është sipas tabelës me përlogaritjet e detyrimit ndaj palës kreditore, si më poshtë:

<i>Shuma e Detyrimit:</i>	<i>Detyrimi Kryesor</i>	<i>Totali</i>
<i>Vendimi nr. 425, datë 28.02.2023 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.</i>	-	-
<i>Shuma e Vendimit</i>		-
<i>Shpenzime gjyqësore:</i>		
<i>Takse padie</i>		3,200
<i>Shpenzime Av/Padites</i>		120,000
<i>Shpenzime Eksperti</i>		
<i>Takse vendimi</i>		
<i>Shuma shpen.Gjyqësore</i>		123,200
<i>Shuma Totale sipas tit.ekzekutiv</i>		123,200

3. Shlyerja e tarifës përbarimore, do të llogaritet sipas legjislacionit në fuqi, në momentin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

4. Fondi për financim, do të përballohet nga buxheti afatmesëm i miratuar, sipas aftësisë paguese të institucionit.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion Veliaj

